

VENDIM

Nr. 766, datë 12.11.2014

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR
GJYKATËN KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Gjykatës Kushtetuese, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, në zërin “Shpenzime kapitale”, t’i shtohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Gjykata Kushtetuese për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama